

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Asseco SEE Sh.p.k. ("Shoqëria") u themelua në 30 prill 2007 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare që veprojnë në Shqipëri. Zyrat e saj qendrore ndodhen në Tiranë.

Gjatë vitit 2010 Shoqëria mori në zotërim Pexim sh.p.k., sipas vendimit të aksionarëve më 25 nëntor 2010.

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 prej 360,000 Lekë zotërohet plotësisht nga "ASSECO SEE" sh.p.k, Prishtinë, Kosovë (shoqëria kontrolluese), e cila është aksionari i vetëm.

Shoqëria u themelua për qëllime të ofrimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit si dhe për zhvillimin e software-ve në Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 7 punonjës (2017: 9 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **a) Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare bashkëngjitur janë të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

### **b) Baza e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike.

### **c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Pasqyrat financiare janë të shprehura në Lekë që është edhe monedha funksionale dhe e paraqitjes e vendit.

### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimet dhe supozimet e tyre që ndikojnë në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë raportuese dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale, duke pasur parasysh thjeshtësinë e natyrës së veprimeve që Shoqëria kryen.



**3. Politikat bazë kontabël**

Shoqëria ka aplikuar vazhdimisht politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periodat të paraqitura në këto pasqyra financiare.

**a) Transaksione në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj duhet të konvertohen me kursin të këmbimit në datën e transaksionit. Për shkak të kufizimeve në sistemin kontabël, Shoqëria përdor kurse të ndryshme këmbimi ndërkohë që regjistron transaksionet dhe në momentin e lëshimit të faturës.

Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja në monedhë të huaj nga njësitë monetare është diferenca ndërmjet konvertimit të një numri të caktuar njësisht në monedhë të huaj në Lekë me kurse të ndryshme të këmbimit. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj, konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit, ndërsa ato të cilat maten me vlerën e drejtë konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në pasqyrën e performancës. Kursi i këmbimit në fund të vitit 30 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë:

|         | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|---------|-------------------------------|-------------------------------|
| EUR/LEK | 123.42                        | 132.95                        |
| USD/LEK | 107.82                        | 111.10                        |

**b) Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk kanë vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që lidhen, përveç siç përshkruhet më poshtë. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare trajtohen në datën e tregtimit, pra në datën që Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë përfundojnë ose shkarkohen ose anulohen.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga gjendja e parave të gatshme, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat e pakufizuara me afat maturimi prej tre muajsh ose më pak nga data e krijimit.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto minus humbjet nga zhvlerësimi. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur ka dëshmi objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve origjinale të të arkëtueshmeve. Vështirësitë e rëndësishme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, si dhe mosveprimi ose paaftësia paguese konsiderohen tregues se llogaritë e arkëtueshme do zhvlerësohen. Shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.



**3. Politikat bazë kontabël (vazhdim)****b) Instrumentet financiare (vazhdim)***Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme janë të shprehura në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë të ngjashme me vlerën e tyre neto kontabël.

*Metoda e interesit efektiv*

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të shpërndarjen e shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit pagesat e ardhshme të parave të gatshme nëpërmjet jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, sipas rastit, një periudhe më të shkurtër.

**c) Inventari**

Inventari njihet fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohet me më të voglën mes koston dhe vlerës neto së realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes për njësi e zvogëluar me koston e ndryshueshme të shitjes. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën FIFO dhe përbëhet nga kosto e blerjeve dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta të lidhura me sjelljen e inventarin në gjendjen aktuale.

**d) Aktivët afatgjatë materiale***(i) Njohja dhe matja*

Elementët e aktiveve afatgjatë materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënien në vlerë, nëse ka të tillë.

Blerja e programeve kompjuterike (software), të cilët janë thelbësorë në funksionimin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e pajisjes. Pjesë të ndryshme të një aktivi afatgjatë material, të cilat kanë afate të ndryshme përdorimi, kontabilizohen si zëra të veçanta të aktiveve.

*(ii) Kosto të mëtejshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën neto kontabël të zërit nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të gjeneruara nga pjesa do të rrjedhin në Shoqëri dhe koston e saj mund të maten me besueshmëri. Shpenzimet e shërbimit të përditshëm të pronës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e performancës si të ndodhura.

*(iii) Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e performancës financiare në përputhje me Legjislacionin Shqiptar duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Normat e përdorura të zhvlerësimit janë si më poshtë:

**Aktivët**

Mjete transporti

Pajisje zyre

**2018****2017**

20%

20%

20% - 25%

20% - 25%



### **3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)**

#### **e) Zhvlerësimi**

##### *(i) Aktivet financiare*

Aktivët financiarë, të cilët nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes humbjes ose fitimit, vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues objektiv për rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet të jetë zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se, një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, kanë pasur një ndikim në rrjedhën e pritshme të mjeteve monetare të aktivit financiar, të cilat mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare, të cilat janë të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e performancës financiare dhe mbahen në një llogari provigjoni, që zvogëlon llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton uljen e rënies në vlerë, zvogëlimi i rënies në vlerë regjistrohet përmes humbjes ose fitimit.

##### *(ii) Aktivet jo-financiare*

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare për të përcaktuar nëse ka tregues për rënien e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen përmes humbjes ose fitimit.

#### **f) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në peridhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen dhe kontrolli është transferuar nga shitësi te blerësi. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen përgjatë kohës. Të ardhurat maten në bazë të shumës të cilën Shoqëria pret të marrë në bazë të kontratës me një klient dhe përjashton shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat nga shitja e pajisjeve teknologjike informative njihen kur kontrolli i mallrave është transferuar, kur ato janë dorëzuar në vendndodhjen specifike të klientit (dorëzimi). Llogaria e arkëtueshme është një e drejtë e njësisë ekonomike për shumën korresponduese që nuk është e kushtëzuar. E drejta për shumën është e pakushtëzuar nëse për ta konsideruar të detyrueshme për t'u paguar mjafton vetëm kalimi i kohës.

#### **g) Të ardhura financiare dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimin nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi nga huatë, humbje nga kurset e këmbimit dhe rënien në vlerë të njohur në lidhje me aktivet financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.



### **3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)**

#### **h) Shpenzime për tatimin mbi fitimin**

##### *(i) Tatimi aktual*

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet i tatim fitimin njihet përmes humbjes ose fitimit, me përjashtim të rasteve kur ai lidhet me zëra të njohur direkt në kapitalin e vet.

Detyrimi aktual për tatim fitimin është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën e tatimit të deklaruar, ose pjesërisht të deklaruar në datën e raportimit dhe çdo tatim të pagueshëm në lidhje me vitet paraardhëse.

##### *(ii) Tatimi i shtyrë*

Tatim-fitimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, mbi diferenca të përkohshme që lindin nga baza tatimore e aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre kontabël të mbartur në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë matet me norma tatimore që pritet të aplikohen mbi diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar mbi ligjet tatimore të deklaruar, ose pjesërisht të deklaruar në datën e raportimit.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë për të cilën ekziston mundësia që do të ketë rrjedhje të fitimeve të ardhshme të tatueshme, përkundrajt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet deri në masën kur përfitimet përkatëse tatimore nuk do të realizohen.

Detyrimi tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

#### **i) Përfitimet e punonjësve**

##### *Kontributet sociale të detyrueshme*

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal operativ, kryen pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar në sigurimet shoqërore të detyrueshme, bazuar në legjislacionin shqiptar. Kostot e kryera në emër të Shoqërisë regjistrohen në pasqyrën e performancës financiare kur ndodhin.

#### **j) Qiraja operative**

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën e performancës financiare në një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë.

#### **k) Transaksionet me palët e lidhura**

Një palë konsiderohet e lidhur nëse: (a) direkt, ose indirekt, nëpërmjet një ose disa ndërmjetësve, pala: (i) kontrollon, ose kontrollohet nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike, (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; (b) pala është një pjesëmarrje; (c) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësinë ekonomike është një sipërmarrje; (d) pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj; (e) pala është një familjar i afërt i ndonjë prej individëve referuar pikës (a) ose (d); (f) pala është një njësi ekonomike që kontrollohet, bashke kontrollohet apo me ndikim të rëndësishëm, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e); ose (g) pala është një skemë e përfitimit pas – punësimit për përfitimin e punonjësve të njësisë ekonomike. Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve, pavarësisht nëse është vënë një çmim.



Asseco SEE SH.P.K.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në Lekë, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe)

#### 4. Aktivet afatgjata materiale

| <i>Kosto</i>                      | Mjete transporti | Pajisje zyre      | Totali            |
|-----------------------------------|------------------|-------------------|-------------------|
| Gjendja më 1 janar 2017           | 5,552,663        | 11,192,766        | 16,745,429        |
| Shtesa                            | 1,368,063        | 9,446,232         | 10,814,295        |
| Pakësime                          | (683,650)        | (367,395)         | (1,051,045)       |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b> | <b>6,237,076</b> | <b>20,271,603</b> | <b>26,508,679</b> |
| Shtesa                            | -                | 4,065,223         | 4,065,223         |
| Pakësime                          | -                | -                 | -                 |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b> | <b>6,237,076</b> | <b>24,336,826</b> | <b>30,573,902</b> |
| <i>Amortizimi i akumuluar</i>     |                  |                   |                   |
| Gjendja më 1 janar 2017           | 3,747,835        | 4,504,481         | 8,252,316         |
| Shpenzimet e amortizimit të vitit | (528,049)        | (2,396,778)       | (2,924,827)       |
| Pakësime                          | (543,045)        | (290,728)         | (833,773)         |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b> | <b>3,732,839</b> | <b>6,610,531</b>  | <b>10,343,370</b> |
| Shpenzimet e amortizimit të vitit | 503,994          | 3,817,881         | 4,321,875         |
| Pakësime                          | -                | -                 | -                 |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b> | <b>4,236,833</b> | <b>10,428,412</b> | <b>14,665,245</b> |
| <i>Vlera e mbetur</i>             |                  |                   |                   |
| Më 1 janar 2017                   | 1,804,828        | 6,688,285         | 8,493,113         |
| Më 31 dhjetor 2017                | 2,504,237        | 13,661,072        | 16,165,309        |
| Më 31 dhjetor 2018                | 2,000,243        | 13,908,414        | 15,908,657        |

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka dhënë me qira disa asete për vlerën prej 17,492,044 Lekë (2017: 15,760,049). Shoqëria ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi aktivet. Aktivet e dhëna me qira klasifikohen si pajisje zyre dhe amortizohen me 25%.

**5. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

|                                        | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|----------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Mallra për shitje                      | 7,759,788                     | 7,844,709                     |
| Mallra për t'u dhënë me qira           | 165,378                       | 113,178                       |
| Kompensim nga zhvlerësimi i inventarit | (2,063,301)                   | (1,695,592)                   |
| <b>TOTALI</b>                          | <b>5,861,865</b>              | <b>6,262,295</b>              |

Inventari përbëhet nga pajisje elektronike që përdoren nga Shoqëria gjatë aktivitetit normal, si për shembull ATM-të, skaner, printera, lexues kartash, etj.

Ky inventar do përdoret nga Shoqëria në përmbushjen e kontratave ekzistuese të shitjeve dhe mirëmbajtjes gjatë vitit 2018 e në vijim.

Zhvlerësimi i inventarit në 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

|                                                         | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Në 1 janar                                              | (1,695,592)                   | (1,210,481)                   |
| Zhvlerësimi i vlerës neto të realizueshme të inventarit | (367,709)                     | (485,111)                     |
| <b>Në 31 dhjetor</b>                                    | <b>(2,063,301)</b>            | <b>(1,695,592)</b>            |

**6. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera**

|                                             | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|---------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Llogari të arkëtueshme                      | 21,328,474                    | 14,886,085                    |
| Të ardhura të përlllogaritura nga shërbimet | 307,071                       | 194,641                       |
| Aktive të tjera afatshkurtra                | 5,886,143                     | 891,833                       |
| <b>TOTALI</b>                               | <b>27,521,688</b>             | <b>15,972,559</b>             |

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë vlera të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe shërbimeve të cilat lidhen me fatura ende të papaguara, të lëshuara gjatë muajve të fundit të vitit dhe të maturuara, si edhe balanca me vonesë por jo të zhvlerësuara ndaj Phonext sh.p.k. (shih shënimin 18).



**7. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

|                 | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|-----------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Paraja në arkë  | <b>1,539,637</b>              | <b>550,135</b>                |
| Në LEK          | 784,610                       | 176,147                       |
| Në EUR          | 755,027                       | 373,988                       |
| Paraja në bankë | <b>23,493,340</b>             | <b>28,264,556</b>             |
| Në LEKËË        | 6,560,720                     | 4,324,953                     |
| Në USD          | 42,313                        | 2,608,295                     |
| Në EUR          | 16,890,307                    | 21,331,308                    |
| <b>TOTALI</b>   | <b>25,032,977</b>             | <b>28,814,691</b>             |

**8. Kapitali i paguar**

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 360,000 Lekë (31 dhjetor 2017: 360,000 Lekë) që përbëhet nga 360 kuota (2017: 360) me një vlerë nominale prej 1,000,000 Lekë (2017: 1,000 Lekë).

Rezervat ligjore përbëhen si më poshtë:

|                 | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|-----------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Më 1 janar      | 360,000                       | 360,000                       |
| Rezerva ligjore | 36,000                        | 36,000                        |
| <b>TOTALI</b>   | <b>396,000</b>                | <b>396,000</b>                |

**9. Llogari të pagueshme dhe të tjera**

|                               | <b>Më 31<br/>dhjetor 2018</b> | <b>Më 31<br/>dhjetor 2017</b> |
|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Të pagueshme ndaj furnitorëve | 518,547                       | 6,949,491                     |
| Tatime të tjera të pagueshme  | 3,800,352                     | 1,730,604                     |
| Detyrime të tjera             | 6,779,587                     | 207,327                       |
| Të pagueshme ndaj personelit  | 218,715                       | 344,535                       |
| <b>TOTALI</b>                 | <b>11,317,201</b>             | <b>9,231,957</b>              |

Në 31 dhjetor 2018, detyrimet e tjera tatimore përbëhen kryesisht nga tatimi i pagueshëm mbi vlerën e shtuar.



**10. Të arkëtueshme nga tatim fitimi aktual**

Të arkëtueshme nga tatimi përfaqëson tejkalimin e parapagimeve për tatim fitimin e vitit mbi detyrimin e llogaritur për tatim fitimin (2017: Tatim fitimi i parapaguar).

Një rakordim i të arkëtueshme nga tatimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, është si vijon:

|                                                 | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|-------------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Në 1 janar                                      | 1,076,474                                         | 1,390,280                                         |
| Tatim fitimi i paguar gjatë vitit               | -                                                 | 526,923                                           |
| Shpenzim i tatim fitimit për vitin (shënimi 15) | (315,583)                                         | (840,729)                                         |
| <b>Tatim fitimi i arkëtueshëm aktual</b>        | <b>760,891</b>                                    | <b>1,076,474</b>                                  |

**11. Të ardhurat**

Të ardhurat nga shitjat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si në vijim:

|                          | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|--------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Të ardhura nga shërbimet | 50,434,094                                        | 50,005,558                                        |
| Shitja e mallrave        | 5,113,597                                         | 1,015,036                                         |
| <b>TOTALI</b>            | <b>55,547,691</b>                                 | <b>51,020,594</b>                                 |

**12. Blerja e materialeve dhe produkteve**

Kosto e materialeve dhe produkteve të shitura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si në vijim:

|                                 | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|---------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Produkte dhe materiale të blera | 18,354,746                                        | 15,142,737                                        |
| <b>TOTALI</b>                   | <b>18,354,746</b>                                 | <b>15,142,737</b>                                 |

**13. Shpenzimet e personelit**

|                                        | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|----------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Shpenzimet e pagës                     | 7,740,550                                         | 6,170,478                                         |
| Kontributet shoqërore dhe shëndetësore | 1,251,508                                         | 2,466,001                                         |
| <b>TOTALI</b>                          | <b>8,992,058</b>                                  | <b>8,636,479</b>                                  |



**14. Shpenzime administrative**

|                                         | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|-----------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Alokimi i kostove me Shoqëritë e Grupit | 6,050,851                                         | 7,287,184                                         |
| Zhvlerësimi                             | 4,321,875                                         | 2,924,827                                         |
| Provigjone                              | 1,936,978                                         | 2,211,568                                         |
| Qiratë                                  | 2,122,441                                         | 2,090,359                                         |
| Shërbime të konsulencës                 | 2,646,041                                         | 1,478,081                                         |
| Naftë dhe të tjera                      | 1,763,067                                         | 1,093,873                                         |
| Telekomunikacioni                       | 575,433                                           | 1,074,278                                         |
| Shpenzime mirëmbajtje                   | 485,928                                           | 841,635                                           |
| Komisione bankare                       | 614,942                                           | 554,381                                           |
| Udhëtime e dieta                        | 879,512                                           | 215,887                                           |
| Sigurimet                               | 166,185                                           | 41,118                                            |
| Shpenzime të tjera                      | 3,661,414                                         | 2,169,182                                         |
| <b>TOTALI</b>                           | <b>25,224,667</b>                                 | <b>21,982,373</b>                                 |

Alokimi i kostove me Shoqëritë e Grupit përbëhet nga shpenzime të cilat faturohen nga Asseco SEE Kosovo për shërbimet e implementimi.

Në 31 dhjetor 2018 dhe 2017, shpenzimet e tjera përbëhen nga shërbime noteriale, shpenzime për reklama si dhe shpenzime të tjera shtesë.

**15. Shpenzime financiare neto**

|                                     | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|-------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Humbja neto nga kurset e këmbimit   | (1,229,044)                                       | (1,520,284)                                       |
| <i>Fitimi nga kurset e këmbimit</i> | 4,145,424                                         | 2,573,990                                         |
| <i>Humbja nga kurset e këmbimit</i> | (5,374,468)                                       | (4,094,274)                                       |
| Të ardhurat nga interesat e huasë   | 518                                               | 137                                               |
| <i>Të ardhura nga interesat</i>     | 518                                               | 137                                               |
| <b>TOTALI</b>                       | <b>(1,228,526)</b>                                | <b>(1,520,147)</b>                                |



**16. Shpenzimi për tatim fitimin**

Paraqitja e mëposhtme është një rakordim i normës efektive të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

|                                                    | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur<br>më 31 dhjetor 2017 |
|----------------------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------|
| <b>Fitimi i vitit</b>                              | 1,808,642                                 | 3,899,345                                 |
| Shpenzime të pazbritshme                           | 2,059,139                                 | 1,705,515                                 |
| <b>Fitimi i tatueshëm</b>                          | <b>3,867,781</b>                          | <b>5,604,860</b>                          |
| Norma efektive e tatimit                           | 15%                                       | 15%                                       |
| Norma efektive e tatimit                           | 5%                                        | -                                         |
| <b>Shpenzimi për tatimin mbi fitimin</b>           | <b>315,583</b>                            | <b>840,729</b>                            |
| Shpenzime nga tatimi i shtyrë                      | -                                         | -                                         |
| <b>Totali i shpenzimit për tatimin mbi fitimin</b> | <b>315,583</b>                            | <b>840,729</b>                            |

Pas një ndryshimi në legjislacionin tatimor gjatë vitit 2018, shoqëria ka aplikuar normën tatimore prej 5% në fitimin neto para tatimit në lidhje me shërbimet për shitjen dhe mirëmbajtjen e software-ve.

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishikohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose në thelb të miratuara deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo ligj të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për ndëshkimet, interesat dhe tatimet tjera nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

**17. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët konsiderohen të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar ose ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër për marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët.

Shoqëria Mëmë është Asseco SEE Kosovo

Vëllimi i këtyre transaksioneve dhe balancave të papaguara në fund të periudhave përkatëse ishin si më poshtë:

| <b>Pasqyra e Pozicionit Financiar</b> | <b>Më<br/>31 dhjetor 2018</b> | <b>Më<br/>31 dhjetor 2017</b> |
|---------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| <b>Detyrimet</b>                      |                               |                               |
| Asseco SEE Kosovo                     | 3,317,317                     | 2,888,686                     |
| Asseco SEE Belgrade                   | 570,903                       | 443,667                       |
| Asseco SEE Poland                     | 468,009                       | 397,122                       |
| Asseco SEE Macedonia                  | 2,117,696                     | 357,616                       |
| Payten d.o.o                          | 185,132                       | 257,306                       |
| Asseco SEE Zagreb                     | 901,787                       | -                             |
| <b>Totali i të pagueshmeve</b>        | <b>7,560,844</b>              | <b>4,344,397</b>              |

| <b>Pasqyra e Performancës Financiare</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Për vitin e mbyllur<br/>më 31 dhjetor 2017</b> |
|------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| <b>Shitjet</b>                           |                                                   |                                                   |
| Asseco SEE Kosovo                        | 191,048                                           | 285,069                                           |
| <b>Shitjet te palët e lidhura</b>        | <b>191,048</b>                                    | <b>285,069</b>                                    |
| <b>Purchases</b>                         |                                                   |                                                   |
| Asseco SEE Kosovo                        | (10,691,544)                                      | (12,921,355)                                      |
| Asseco SEE Macedonia                     | (10,691,544)                                      | (3,604,074)                                       |
| Asseco SEE Belgrade                      | (1,005,091)                                       | (1,721,500)                                       |
| Asseco SEE Poland                        | (1,716,462)                                       | (1,415,316)                                       |
| Payten d.o.o                             | (946,825)                                         | (259,629)                                         |
| Payten d.o.o Belgrade                    | (785,487)                                         | -                                                 |
| Payten d.o.o.e.l Scopje                  | (5,628,757)                                       | -                                                 |
| Asseco SEE Croatia                       | (2,908,352)                                       | -                                                 |
| <b>Blerje nga palët e lidhura</b>        | <b>(34,374,062)</b>                               | <b>(19,921,874)</b>                               |
| <b>Totali</b>                            | <b>(34,183,014)</b>                               | <b>(19,636,805)</b>                               |

Blerjet nga palët e lidhura përbëhen kryesisht nga shërbime të marra nga shoqëri të grupit.

**Kompensimet e Drejtuesve kryesorë**

Kompensimet e Drejtuesve kryesorë që përfshijë pagat dhe shpërblimet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, janë 1,849,068 Lekë (2017: 749,584 Lekë).



**18. Manaxhimi i rrezikut financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme në përdorimin e instrumentave financiarë:

- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku i kredisë
- Rreziku operacional

Në këtë shënim jepet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe procedurat për të matur dhe menaxhuar këtë risk, si dhe drejtimin e kapitalit.

**a) Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 si më poshtë:

|                                               | Shuma në pasqyrat<br>financiare | 3 muaj ose<br>më pak | 3 deri në 12<br>muaj | 1 deri në 5 vjet |
|-----------------------------------------------|---------------------------------|----------------------|----------------------|------------------|
| <i>Detyrimet financiare</i>                   |                                 |                      |                      |                  |
| Llogari të pagueshme<br>tregtare dhe të tjera | 11,317,201                      | 11,317,201           | -                    | -                |
| Të pagueshme ndaj<br>palëve të lidhura        | 7,560,844                       | 7,560,844            | -                    | -                |
| <b>Më 31 dhjetor 2018</b>                     | <b>18,878,045</b>               | <b>18,878,045</b>    | <b>-</b>             | <b>-</b>         |
|                                               |                                 |                      |                      |                  |
|                                               | Shuma në pasqyrat<br>financiare | 3 muaj ose<br>më pak | 3 deri në 12<br>muaj | 1 deri në 5 vjet |
| <i>Detyrimet financiare</i>                   |                                 |                      |                      |                  |
| Llogari të pagueshme<br>tregtare dhe të tjera | 9,231,957                       | 9,231,957            | -                    | -                |
| Të pagueshme ndaj<br>palëve të lidhura        | 4,344,397                       | 4,344,397            | -                    | -                |
| <b>Më 31 dhjetor 2017</b>                     | <b>13,576,354</b>               | <b>13,576,354</b>    | <b>-</b>             | <b>-</b>         |

**b) Rreziku i tregut*****Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit***

Rreziku i kursit të këmbimit është Rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të luhetet si pasojë e ndryshimeve në normat e këmbimit valutor. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj kurseve të këmbimit sjell rritje të fitimeve ose humbjeve nga kurset e këmbimit të cilat njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përfshijnë aktivet monetare dhe detyrimet monetare të Shoqërisë të cilat nuk janë të shprehura në monedhën funksionale të Shoqërisë.

Normat e aplikueshme të këmbimit (Lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

|       | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|-------|-----------------|-----------------|
| 1 EUR | 123.42          | 132.95          |
| 1 USD | 107.82          | 111.1           |

**18. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****b) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)***

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, sipas monedhave të huaja në të cilën ato janë të shprehura është si vijon:

|                                        | Vlera<br>kontabël | EUR               | LEK              | USD              |
|----------------------------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|
| <b><i>Aktivitet financiar</i></b>      |                   |                   |                  |                  |
| Llogari të arkëtueshme dhe të tjera    | 27,521,688        | 27,420,464        | 101,224          | -                |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre | 25,032,977        | 17,645,334        | 7,345,329        | 42,313           |
| <b>Totali</b>                          | <b>52,554,665</b> | <b>45,065,798</b> | <b>7,446,553</b> | <b>42,313</b>    |
| <b><i>Detyrime financiare</i></b>      |                   |                   |                  |                  |
| Llogari të pagueshme dhe të tjera      | 11,317,201        | 11,258,649        | 58,552           | -                |
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura    | 7,560,844         | 7,560,844         | -                | -                |
| <b>Totali</b>                          | <b>18,878,045</b> | <b>18,819,493</b> | <b>58,552</b>    | <b>-</b>         |
| <b>Më 31 dhjetor 2018</b>              | <b>33,676,620</b> | <b>26,246,306</b> | <b>7,388,001</b> | <b>42,313</b>    |
|                                        | Vlera<br>kontabël | EUR               | LEK              | USD              |
| <b><i>Aktive financiare</i></b>        |                   |                   |                  |                  |
| Llogari të arkëtueshme dhe të tjera    | 15,972,559        | 15,871,335        | 101,224          | -                |
| Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre | 28,814,691        | 23,472,436        | 2,733,960        | 2,608,295        |
| <b>Totali</b>                          | <b>44,787,250</b> | <b>39,343,771</b> | <b>2,835,184</b> | <b>2,608,295</b> |
| <b><i>Detyrime financiare</i></b>      |                   |                   |                  |                  |
| Llogari të pagueshme dhe të tjera      | 7,501,353         | 7,413,408         | 87,945           | -                |
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura    | 4,344,397         | 4,344,397         | -                | -                |
| <b>Totali</b>                          | <b>11,845,750</b> | <b>11,757,805</b> | <b>87,945</b>    | <b>-</b>         |
| <b>Më 31 dhjetor 2017</b>              | <b>32,941,500</b> | <b>27,585,966</b> | <b>2,747,239</b> | <b>2,608,295</b> |



**18. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****b) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)****Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit*

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe e mbajtur konstante gjatë periudhës raportuese. Më poshtë është një paraqitje e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi pozicionin neto, duke konsideruar të gjitha variablat e tjera konstante:

|                         | <b>Më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Më 31 dhjetor 2017</b> |
|-------------------------|---------------------------|---------------------------|
| EUR zhvlerësohet me 10% | (2,624,630)               | (2,758,597)               |
| EUR rivlerësohet me 10% | 2,624,630                 | 2,758,597                 |

|                         | <b>Më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Më 31 dhjetor 2017</b> |
|-------------------------|---------------------------|---------------------------|
| USD zhvlerësohet me 10% | (4,231)                   | (260,830)                 |
| USD rivlerësohet me 10% | 4,231                     | 260,830                   |

**c) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit konsiston në rrezikun që vlera e instrumentit financiar do të ndryshojë si pasojë e ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe në rrezikun që maturitetet e aktiveve të cila mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve të cila mbartin interes, të cilat përdoren për të financuar aktivet në fjalë. Periudha kohore për të cilën norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse rrjedhimisht tregon se sa është ky mjet i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

**d) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Shoqërisë nëse një klient apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të kredisë që mund të ndikojë në pozicionin financiar ose në ecurinë e Shoqërisë për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, vlera e llogarive të arkëtueshme që nuk ishin të zhvlerësuara ishin si më poshtë

|                                  | <b>Më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Më 31 dhjetor 2017</b> |
|----------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Në afat                          | 27,124,457                | 13,326,025                |
| Me vonesë por jo të zhvlerësuara | 397,231                   | 2,646,534                 |
| <b>Totali</b>                    | <b>27,521,688</b>         | <b>15,972,559</b>         |

**18. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**d) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Lëvizjet në kompesimin për zhvlerësim në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera gjatë vitit ishin si më poshtë

|                                 | <b>Më 31 dhjetor 2018</b> | <b>Më 31 dhjetor 2017</b> |
|---------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Gjendja në 1 janar,             | 342,460                   | 342,460                   |
| Humbja e njohur nga zhvlerësimi | -                         | -                         |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor</b>    | <b>342,460</b>            | <b>342,460</b>            |

**19. Paraqitjet dhe vlerësimet e vlerës së drejtë**

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentat financiare të pasqyrës së pozicionit financiar pa vlerësuar pritshmërinë mbi të ardhmen e biznesit dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve jo të konsideruara si intrumenta financiare.

Vlera e drejtë e vlerësuar e aktiveve dhe detyrimeve financiare përaftron vlerën e tyre kontabël në pasqyrën e pozicionit financiar për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose normave përkatëse të interesit, të cilat janë të përafërta me normat e tregut.

**20. Angazhimet dhe pasiguritë**

**Angazhimet e qirasë operative**

Shoqëria ka lidhur një marrëveshje qiraje për pajisjet e zyrës. Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka detyrime të qirasë jo-të anulleshme prej 2,122,441 Lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 442,695 Lekë)

**21. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës 31 dhjetor 2018, që kërkojnë ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.